



Kuvendi i Komunës Klinë

Debat me Publikun

01Nr 06-22782 /23

Klinë, dt: 11.07 /23

PROCESVERBAL

Nga Debati me Publikun, mbajtur, më 13.06.2023, me fillim nga ora 10:00, në sallën e Kuvendit të Komunës.

Mbledhjen e udhëhoqi kryesuesi i Kuvendit, z. Fadil Gashi, ku të pranishëm ishin nënkryetarja e komunës, znj. Marqe Tanushi-Selmanaj, zyrtarë tjerë komunalë, drejtori i OSBE-së dhe qytetarë të Komunës së Klinës.

RENDI I DITËS

1. Draft-Strategjia për Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun 2023-2026,
2. Draft-Plani i Veprimit për Informim dhe Komunikim 2023-2026.

Fadil Gashi, kryesues: Përshëndetje, mirë se keni ardhur në këtë dëgjim publik!

Unë si kryesues i Kuvendit, falënderoj nënkryetaren e komunës që është bashkë me ne, zyrtaren për Informim, stafin, ju të pranishëm, zyrtarë tjerë, edhe ju që jeni fizikisht sot me ne, edhe të atyre që janë duke na përcjellë drejtpërdrejt prej mediumeve tona lokale në Klinë. Falënderoj gjithë ata që kanë qenë pjesë e jona këtyre ditëve, prej momentit kur janë shpallur publikisht këto dy drafte dhe ne kemi pranuar edhe propozime, kemi pranuar sugjerime prej qytetarëve, prej kategorive të ndryshme edhe në formë elektronike. Prandaj, duke u bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, duke u bazuar në Rregulloren e punës së Kuvendit, pastaj rregulloreve tjera që derivojnë edhe prej nivelit qendror edhe lokal, që rregullojnë këtë fushë, sot, jemi këtu bashkërisht me ju. Ne i kemi sot përpara dy drafte që kishim pasur dëshirë t'i debatojmë bashkë

me ju, gjithçka që ju e vlerësoni që duhet të plotësohet edhe ndryshohet në këto dy dokumente të rëndësishme, e para është: Draft-Strategjia për Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun 2023-2026 dhe, dokumenti i dytë është: Draft- Plani i Veprimit për Informim dhe Komunikim 2023-2026 .

Unë pa humbur kohë po ja kaloj fjalën zyrtares për Informim, Vlora Tafili, për një prezantim dhe pastaj hapim debat.

Pika 1. Draft-Strategjia për Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun 2023-2026.

Vlora Tafili, zyrtare për Informim: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit që janë në sallë të Kuvendit, përshëndetje për gjithë ata qytetarë që po na ndjekin në transmetim *live* të medimeve tona!

Si zyrtare për Informim, duke u bazuar në kërkesat ligjore, zyra për Informim ka nxjerrë dy dokumente mjaft të rëndësishme për institucionin tonë, nën mbështetjen e kryetarit të komunës dhe veçanërisht zonjës nënkryetare, Marqe Selmanaj, e cila ka qenë kryesuese e grupit punues për hartimin e këtij dokumenti. Ne si institucione po mundohemi që t'i përmbledhim disa rekomandime të cilat dalin nga zyra për Integritet Evropian, rekomandimi nga MAPL-ja si dhe rekomandime tjera për raport të performancës dhe transparencës sonë institucionale, prandaj i kemi hartuar këto dy dokumente.

Për të thjeshtësuar më shumë edhe për të kuptuar rëndësinë e këtij dokumenti, e para është se strategjia është e ndërtuar në tri pjesë: Pjesa e parë është bërë një analizë e deritanishme e zyrës së Informimit dhe Komunikimit, që e kanë pasur brenda me zyrtarët e jashtëm, audiencat edhe grupet tjera të interesit, duke i vlerësuar gjendjen, kornizën ligjore, mjetet ekzistuese të cilat i kemi si zyrë për Informim, pastaj kemi dalë të krijojmë mekanizmat për informim. Duke i marrë për bazë të gjitha rekomandimet që i kanë daljet në indeks të ndryshme për transparencë lokale buxhetore dhe të tjera, ne i kemi përmbledhur disa rekomandime por që janë një vjeçare të cilat përsëriten vitë pas viti, ndërsa e dyta është ajo që i intereson ndoshta më shumë publikut ku preket më shumë nga këto dy dokumente është rritja e transparencës dhe ndërveprimi me qytetarë. Do të thotë këtu hyn edhe ky indikator i cili tash ne jemi edhe para jush që, sa më shumë të ketë takime me qytetarë të çfarëdo lloji dokumenti dhe ashtu si e kërkojnë kornizat ligjore dhe udhëzimet administrative në fuqi. Ne të ndërveprimi e kemi pasur një kërkesë *online* deri më tani, duke e ditur që këto dy dokumente kanë qenë në konsultim publik në ueb-faqen e komunës 30 ditë, duke plotësuar edhe njëfarë indeksi ligjor, ndërsa ka qenë *online* edhe te qeveria në platformën e konsultimeve publike. Nuk e di nëse keni arritur disa prej jush apo ata që po na ndjekin *online* që t'i shikoni këto dy dokumente, por që tani hapësira ju kushtohet juve, e para ne e kemi pasur një plan të veprimit, përveç transmetimit *online* të seancave, ne po mundohemi të transmetojmë edhe takime të KPF-së, kryesues, nëse na lejohet, faleminderit edhe për mbështetje të kryesuesit. Ne bashkërisht do t'i koordinojmë kërkesat tona çka është për publikun edhe çka duhet të diskutohet me publikun, duke pasur parasysh mbrojtjen e disa të dhënave personale dhe kërkesat të cilat i parashtrijnë qytetarët me KPF. Nëse ka ndonjë kërkesë, duke e parë të arsyeshme, unë si zyrtare e Informimit, ne kemi marrë pak a shumë sugjerime që shpeshherë edhe në *facebook* edhe faqja e komunës nuk janë të mjaftueshme për komunikim me

qytetarë, andaj ne do të ndalemi te pika e tretë edhe rritja e transparencës, çfarë mendoni ju, ne si komunë do të marrim disa hapa për të rritur transparencën komunale, çka duhet të publikojmë më shumë, çka duhet të transmetojmë më shumë *online* edhe çka ka të bëjë në lidhje me kërkesat e juaja ose formatin se si do të shqyrtohen ato në të ardhmen? Jemi duke folur për një faze tri vjeçare, do të thotë komuna e Klinës, do t'i përgatit kërkesat e juaja në një vizion pak më të gjerë, kështu që, të gjitha ato që ju i thoni dhe që do të shënohen në procesverbal, do të jenë pjesë e raportit të shqyrtimeve publike dhe të cilat do të miratohen në Kuvend.

Fadil Gashi, kryesues: Atëherë e falënderoj zyrtaren për prezantim, unë po hap debat, nëse ka dikush prej jush rreth dokumentit të parë, Strategjia për Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun, urdhëroni! Po, urdhëro, Binak Gashi?

Binak Gashi: Përshëndetje për të gjithë, përshëndetje për kryesuesin e Kuvendit, nënkryetaren e Komunës, Vlorën dhe gjithë anëtarët e Kuvendit Komunal të Klinës! Kam qenë para tri viteve shumë aktiv dmth në debate me qytetarë, qe tri vite kam stagnuar, mirëpo e kam parë nevojën se prapë duhet me u kyç edhe me qenë në debate që organizohen nga Kuvendi Komunal.

Sa i përket transparencës dmth me qytetarë, unë ju kisha propozuar që një pjesë të madhe të komunave të Republikës së Kosovës m'i mbajtur zgjedhjet nëpër fshatra, nëpër lagje ndërurbane, me kërkesë të qytetarëve, fshatarëve që janë në nivel me Kuvendin Komunal.

Pra, unë e kisha bërë si kërkesë që të organizohen zgjedhjet nëpër fshatra.

Fadil Gashi, kryesues: Faleminderit, ne i marrim në përgjithësi, pastaj ato që duhet t'i sqarojmë, i sqarojmë në fund. Dikush tjetër?

Vlora Tafili, zyrtare për Informim: A mendoni që në komunën e Klinës duhet të jetë prezent edhe një platformë tjetër, në përjashtim të *facebookut* edhe të ueb-faqes zyrtare, a e keni shumë më të lehtë që të qaseni në këto dyja apo duhet edhe ndonjë formë tjetër *online*, a është ndonjë dokument që ju keni pasur gjithmonë nevojë, i cili nuk gjendet në ueb-faqe, por që mund të ekzistojë tani e tutje në vjeggëzat e ueb-faqes?

Fadil Gashi, kryesues: Ne e kemi themeluar komisionin për zgjedhjen e këshillave të fshatrave, por unë e di që bukur fort ju ka ofruar punës, është në implementim ajo kërkesë e juaja. Unë besoj që shumë shpejt kanë me dalë në terren ata, për të filluar zgjedhjen e këshillave të fshatrave, është përfunduar puna e Kuvendit, drejtori i Administratës është duke e udhëhequr me atë pjesë të komisionit edhe besoj që shume shpejt do t'ja fillojmë me implementim.

Binak Gashi: Faleminderit, se unë e parashoh se ju ndihmon kështu edhe Kuvendit Komunal edhe qytetarëve.

Fadil Gashi, kryesues: Po mund të jenë adresa të komunikimit dhe transparencës e të vendimmarrjes ose diçka tjetër, këshillat e fshatrave, por, ne sot i kemi dy dokumente që i adresohen marrëdhënieve me qytetarin, transmetimin e gjithë asaj që ndodh me ekzekutivin, me kuvendin, me punën që zhvillohet këtu, gjithçka që zhvillohet në komunën e Klinës.

Ne po mundohemi që të avancohemi me dokumente tona dhe t'i përafrojmë sa më shumë, që qytetari të ketë qasje në punën e përditshme dhe në dokumentacionin që prodhon komuna e Klinës, por jo në atë që klasifikohet sipas ligjeve i paqasshëm për qytetarë, sepse janë disa dokumente që unë e kam përshtypjen që ju veç e dini, që një pjesë e dokumenteve janë të klasifikuara, që s'mund të kemi qasje asnjë prej nesh, përpos në procedura tjera çfarë ka përcaktuar ligji, përndryshe krejt pjesa tjetër është publike.

Ne, jo vetëm që ja bëjmë një të mirë qytetarit me këto dokumente, ne i bëjmë mirë edhe vetes sonë, sepse ne e ngrehim edhe performancën tonë për përfitimin e granteve. Sa më transparent që jemi, sa më afër qytetarit që jemi, ne i përfitojmë pastaj edhe grantet tona, sepse rrisin performancën e Komunës e krejt janë në shërbimin tonë të përbashkët, jo si qytetarë e si Komunë, po të gjithë bashkë jemi pjesë e kësaj Komunës sonë, administrativisht si e menaxhojmë edhe si ju qasemi. Po, urdhëro, Ragip Kryeziu?

Ragip Kryeziu: Së pari ju përshëndes të gjithëve, edhe kjo mbledhje po më bën të ndjehem shumë mirë, por duhet me qenë të vetëdijesuar, që të ketë pak më shpesh, bile një herë në muaji, që nga kjo mbledhje kaq e mirë, mund të përfitojmë shumë gjëra çka i duhet këtij populli.

Pra, një; pleqve edhe të rinjve jua bëjmë të pa drejtë, se kanë hyrë shumë gjëra çka nuk i kemi paraparë, nëse i shohim në këtë gjendje si janë, dmth pleqtë kanë nevojë të shëtisin, me të vërtetë janë disa pengesa shumë të mëdha që nuk dinë kah të dalin, e dyta; të rinjtë janë duke u marrë me disa punë që asnjë prindi nuk i pëlqejnë ato gjëra çka janë duke u bërë nëpër shkolla, e treta; për një punë që e bëj unë është shumë e vrazhdë, ndoshta për shumë njerëz, por nëse ne e kemi fituar këtë shtet, nuk kemi nevojë të bëjmë bërlllok, nuk kemi nevojë më që të shohim cigare nëpër tokë, se ajo është puna më e lehtë që mund të vetëdijesohen. Në atë pjesën tonë janë duke u ndërtuar disa kontejnerë, unë ata kontejnerë nuk i kisha propozuar m'i vënë nëpër rrugë, gjithkush mund ta marrë bërlllokun e vet, ta vej në kontejner të vet, përndryshe edhe ndërkombearet japin para, si për kanalizime, si për impiante, si për shumë gjëra çka i vyejnë këtij populli. Për atë nuk jemi të interesuar as 0% , as si komune, as si shtet atje, as askund hiç. Kurrë vlerë më të madhe, e kam thënë 100 herë edhe prapë po e përmendi se, zoti, ajri, toka, dielli, uji, nuk ka në këtë dynja dhe këto gjëra jemi duke i shkatërruar shumë me qëllimin tonë. Ndoshta gabim po flas, por të mundohemi t'i ruajmë fëmijët, pleqtë, ne gjenerata e mesme duhet të mundohemi pak më shumë për ta. Kaq kam, ju faleminderit shumë!

Fadil Gashi, kryesues: Faleminderit, Ragip, je i mrekullueshëm, por nuk je në adresë të saktë. Kështu që, mirë e ke, por ke harruar se para një muaji e kemi miratuar ne Rregulloren për Menaxhimin e Mbeturinave edhe e kemi pasur fjalën, sot i kemi dy dokumente të tjera. Po, Vlora?

Vlora Tafili, zyrtare për Informim: Po, z.Ragip, ne më së shumti kemi nevojë për njerëz aktiv si ti. Unë mendoj që kjo çështje është shtruar siç tha nënkryetarja edhe në Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi, por ne mund ta ndërlidhim çështjen e Ragipit. Në qoftë se Ragipi e ka një ide në pastrimin e ambientit apo mirëmbajtjen e ambientit, mund ta bëjmë transparente nëse dëshiron që ta promovojë ose një diçka tjetër ose nëse e ka një ide që ne si Komunë mund ta bëjmë, ta shfaqim nëpër rrjete ose diçka, atëherë mund të na tregosh.

Fadil Gashi, kryesues: Po, urdhëro, nënkryetarja e Komunës, znj. Marqe Selmanaj?

Marqe Selmanaj, nënkryetare e Komunës së Klinës: Faleminderit, kryesues, Vlora, faleminderit gjithë të pranishmëve!

Në Këshillin për Siguri në Bashkësi, në një ndër temat e kemi edhe ruajtjen e ambientit, ku shpeshherë z. Ragip është pjesëmarrës, edhe pse nuk është pjesë e KKS-së është person që na mbështet me aktivitete dhe ne jemi gjithmonë, siç tha edhe Vlora, me njëfarë forme, ndoshta guxoje të them *krenare* që je pjesë e qytetit dhe kontribuon në ruajtjen dhe ambientin e qytetit. Mbeturinat dhe pjesa që thua ti, sigurisht që shkon në dëm dhe është rrezik për qytetarët dhe për këtë KKS-ja është një Këshill i cili i trajton këto çështje. Sa për pyetjen që e bëri edhe Vlora, pjesë ose një ndër temat në KKS është edhe punimi i një fletëpalosje për vetëdijesimin e qytetarëve që të ruajnë dhe të mbrojnë ambientin, që të jetë vend i sigurt për të gjithë qytetarët e komunës së Klinës, kështu që, të ftoj në takimin e ardhshëm që të jesh pjesë e KKS-së dhe të shohim për hapa të mëtejshëm, dhe që kjo lidhet patjetër edhe me këtë draft-strategji që qytetarët t'i mbajmë të informuar lidhur me punën dhe aktivitetin tonë, faleminderit!

Fadil Gashi, kryesues: Faleminderit, nënkryetare, dikush tjetër? Jemi ende në dokumentin e parë, nëse ka dikush, urdhëroni? Po edhe ata të cilët hezitojnë sot, unë po ju informoj se ju keni mundësi akoma.

Ne e kemi Komitetin për Politikë dhe Financa, takimin e radhës, pastaj në fund të muajit e kemi seancën kur e miratojmë përfundimisht. Deri në atë kohë, po ju inkurajoj juve edhe gjithë atyre që po na dëgjojnë edhe drejtpërdrejt, akoma ka kohë që t'i dërgoni sugjerimet, propozimet, gjithçka që ju e vlerësoni se ne duhet të vendosim në këtë dokument. Nuk është veç dita e sotme ajo që përfundon debatin ose e përfundon mundësinë për ta ndryshuar këtë dokument, a ka dikush? Nëse s'ka, unë kaloj në dokumentin e dytë që e kemi tash Planin e veprimit, që nuk janë të ndara mes vete, por, pothuajse që e plotësojnë njëra-tjetrën; i pari flet për mënyrën se si ne e shohim komunikimin dhe marrëdhëniet tona me qytetarë tanë dhe publikun dhe i dyti është pastaj ai në detaje; plani i veprimit që e shkoqit gjithë aktivitetin e komunës, ekzekutivit, kuvendit, gjithë trupave të tij për vitet në vijim, për sa mbulojnë këto dy dokumente.

Prapë po i jap fjalën zyrtares, Vlora Tafili, ta prezantojë në pika të shkurtra, po besoj se ju veç i keni pranuar dokumentet dhe keni mundur t'i konsultoni, urdhëro!

Pika 2. Draft-Plani i Veprimit për Informim dhe Komunikim 2023-2026.

Vlora Tafili, zyrtare për Informim: Faleminderit, kryesues, unë kur e mora fjalën në fillim e bëra një përmbledhje të përgjithshme, sepse këto dy dokumente, nuk është që ndahen njëra nga tjetra, por për shkak të disa procedurave ligjore, më duhet një vendim i Kuvendit për strategji dhe vendim për Plan të veprimit.

Plani i veprimit është i njëjti, dmth është strategji, por është më i specifikuar në grupe. Do të thotë është elaburuar më shumë, më qartë për juve si publik që keni përfshirë, që ne të ju ndihmojmë për t'u implementuar kjo strategji. Ne e kemi pasur parasysh, që ne kemi pasur kërkesa edhe të mëhershme për ndërhyrje, që kemi për ta bërë në *facebook* dhe në ueb-faqe të

komunës edhe me publikun, sa më shumë *online* edhe dokumente që janë në interes të përgjithshëm edhe transmetime *online*.

Do të thotë, ky dokument: Plani i Veprimit për Informim dhe Komunikim, është thjesht zbërthim i strategjisë në detaje dhe grupe më të vogla.

Fadil Gashi, kryesues: Faleminderit, a ka dikush? Po hap debat!

Binak Gashi: Unë ju përgëzoj për punën, për gjitha këto që i keni përfshirë te Plani i veprimit edhe drafti për strategjinë dmth të publikut, mirëpo e kam një kërkesë edhe e kam parë të nevojshme që të vij në këtë debat për çështjen e ura e Klinës, mungesa e gjeneralizimeve ku po ka aksidente të shumta. Unë e di se s'është përgjegjësi e Kuvendit Komunal, por është dmth e nivelit më lartë, mirëpo kërkoj që Kuvendi Komunal ta ngreh zërin edhe të intervenojë edhe të vihen ato shenja se aksidente po ka shumë të shpeshta. Ne qytetarët e komunës së Klinës po i dimë ato, se është rrethi, ne duhet ta ndalojmë aty shpejtësinë, mirëpo qytetarët jashtë komunës së Klinës, dmth po hasin në atë pengesë dhe po bëjnë aksidente. Vetëm mbrëmë, dmth 5 qytetarë të Republikës së Kosovës janë të lënduar bukur mirë në aksident. Prandaj, kisha kërkuar që në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës edhe një rreth të ndërtohet, për shkak të ardhjes së mërgimtarëve gjatë korrikut dhe gushtit, të ndërtohet edhe një rreth te kryqi aty për Gjakovë, e di se s'është përgjegjësi e komunës mirëpo i kemi organet qeveritare që mund të ndërhyjnë për ta kryer atë punë, faleminderit.

Vlora Tafili, zyrtare për Informim: Zotëri Gashi, sa i përket kërkesës për infrastrukturë, më datën 15 e ke Debatin me Publikun, për Kornizën Afatmesme Buxhetore, dhe mund ta parashtrosh. Desha më shumë m'u ndalë te ajo pjesa që thatë: e kam marr njoftimin me vonesë, edhe për këtë është bërë kjo strategji. Mua më intereson se pse e ke marrë ti njoftimin me vonesë? A mund të siguroj ndonjë mekanizëm tjetër unë, që qytetari ta merr njoftimin me kohë, a ju pëlqejnë këto formate të debatit që ne i bëjmë në Kuvend, a dëshironi me i zhvendos dëgjimet me publikun në objekte tjera, kuptohet në institucionale ose shkollore? Edhe këto do të thotë janë mekanizma se si unë, si zyrë për Informim, mund t'i përmirësoj për ju.

Binak Gashi: Unë jam i kënaqur me informimin këtu që është, por pjesën më të madhe të kohës jam duke jetuar edhe në Prishtinë, se shtëpinë e kam në fshatin Gremnik, nuk është se ka pasur mungesë njoftimi prej komunës, mirëpo informimi im ka qenë dmth i vonshëm.

Fadil Gashi, kryesues: Faleminderit, a ka dikush tjetër? Po e shoh se s'ka, kështu që, më lejoni ta mbyll këtë takim, duke ju falënderuar për pjesëmarrje, faleminderit shumë!

Procesmbajtësja,
Monika Palushi



KRYESUESI,
Fadil Gashi

